



VENDIM

Nr.13 datë 11.02.2015

PËR

LICENSIMIN E SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa “a”, 9 ; 45 pika 4 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neni 4, pika 1, germa “P”; neni 5 pika 1 germa “P” dhe neni 12, 13 dhe neni 14 pika 1, “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008. Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 11.02.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “DRAGOBIA ENERGY ”sh.p.k. sidhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY”sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/ të pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm :

- Neni 9, pika 1
Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 2
Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar në mënyrë korrekte.
Neni 9, pika 3
Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar.

Dokumentacioni teknik,

- Neni 9, pika 4/9, gërma a e plotësuar.
- Neni 9, pika 4/9, gërma b e plotësuar.
- Neni 9, pika 4/9, gërma c e plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojw shoqërinw **“DRAGOBIA ENERGI” sh.p.k.**, për aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjecar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s

Petrit AHMETI